



Kur të merrni këtë kalendar lutjeje, do të kenë kaluar disa ditë nga Rosh Hashana (Viti i Ri hebraik), që festohet në 26-27 Shtator. Çfarë privilegji është të vazhdojmë në lutje të palëkundur për popullin e Perëndisë në vitin e ri hebraik. Përgjatë viteve, përgjigjet e lutjeve tona kanë qenë shpesh të dukshme qartë: mendoni për vazhdimin e aliyas, se si Izraeli ka vazhduar të qëndrojë përpara armiqve të tij dhe dhuratën e optimizmit pavarësisht terrorizmit këmbëngulës. Një tjetër përgjigje lutjeje është kërkesa në rritje për Zotin Perëndi dhe për ardhjen e Mesias. Shumë ndihen se kjo është bërthama e asaj se çfarë do të thotë të jetosh në tokën e Izraelit!

Por ka gjithashtu rreziqe të panumërta që rrezikojnë ekzistencën e Izraelit. Antisemitizmi po rritet dhe kërcënimi i sulmeve terroriste nga Hamasi dhe Hezbollahu vazhdon, i inkurajuar nga Irani. Përveç këtyre, Izraeli përballlet me rrezikun e terrorit kibernetik dhe ndjenjat anti-Izrael dhe fushatën dëmtimit të reputacionit nga Kombet e Bashkuara. Një rrezik tjetër më pak i dukshëm është rritja e laicizmit dhe dëshira për të qenë si çdo komb tjetër, ndërkohë që Bibla thotë qartë: “Me qenë se ti je një popull që je shenjtëruar tek Zoti, Perëndia yt; Zoti, Perëndia yt, të ka zgjedhur për të qenë thesari i tij i veçantë midis tërë popujve që ndodhen mbi faqen e dheut.” (Ligji i Përtërirë 7:6)

Duket sikur ne po shohim një peshore. Nga njëra anë është përmbushja e qindra profecive biblike, në anën tjetër ekzistenca e pasigurt e popullit hebre dhe shtetit hebre. Në cilën anë do të anojë peshorja, në atë të përmbushjes apo zhdukjes? Ne mund të mbahemi fort duke ditur se Perëndia me siguri do ta mbarojë atë që ka filluar. Ju mund ta keni dëgjuar shprehjen: “Perëndia nuk na premtonte një udhëtim të qetë, por Ai premtonte një arritje të sigurt.” Ne shohim të vërtetën e kësaj shprehjeje në udhëtimin e besimit të Izraelit. Si ndërmjetësues kjo nuk duhet të na habisë; në fund të fundit, ne përjetojmë të njëjtën gjë në jetët tona!

Kështu le të ngremë sytë për ardhjen e Mesias së bashku me ta. Ajo do të jetë edhe koha kur pyetjes nëse Jezusi është Mesia, do t’i jepet përgjigja për popullin hebre. Një ish-kryetar i bashkisë së Jerusalemit, Teddy Kollek tha vite më parë: “Kur Mesia të vijë, gjëja e parë që do ta pyes është: ‘Ke qenë këtu më përpara apo e ke herën e parë?’”

Shalom,

Ekipi i lutjes i Të Krishterëve për Izraelin

Tetor 2022

E shtunë
1 Tetor
Shabat

Lutuni për Izraelin duke përdorur Psalmin 102:1, “O Zot, dëgjo lutjen time dhe britma ime arriftë tek ty.” dhe Psalmin 116:1, “Unë e dua Zotin, sepse ai dëgjo zërin tim dhe lutjet e mia.”

E diel 2 Tetor	Nëse refuzoni të vërtetën e thjeshtë të Romakëve 9, 10 dhe 11, po e lejoni veten të ndikoheni nga një frymë gënjeshtrash. Shpëtimi i Perëndisë për Izraelin është pandashmërisht i lidhur me shpëtimin e botës tonë.
E hënë 3 Tetor	Lutuni që të krishterët do të shikojnë përtej lajmeve të zakonshme të medias (që janë shumë paragjykes) rreth lajmeve për Izraelin. Lutuni që të krishterët do të mundohen të gjejnë burime lajmesh të besueshme dhe ta ndajnë këtë informacion me të tjerët.
E martë 4 Tetor	Lutuni që pastorët dhe drejtuesit e kishave do të jenë besnikë në lutje për Izraelin gjatë shërbesave të kishës dhe të shpjegojnë në predikimet e tyre se ne si të krishterë kemi kemi një lidhje të fortë me popullin hebre. Në Tetorin e hershme, Rev. Cornelis Kant do të udhëtojë në Kuba për takime dhe studime Bible me studentë teologjike në qytete të ndryshme. Falënderoni për këtë mundësi dhe lutuni për udhëtime të sigurta dhe një kohë të bekuar në Kuba.
E mërkurë 5 Tetor Yom Kippur	Dita e shlyerjes. Sot është Yom Kippur. Është dita më e shenjtë e vitit për Izraelin dhe për hebrenjtë në çdo cep të botës. Lutuni që Perëndia do ketë mëshirë për popullin e Tij dhe do ta shfaqë veten e Tij ndërsa ata e kërkojnë Atë.
E enjte 6 Tetor	“Ju pra, shumë të dashur, duke i ditur këto gjëra, ruajuni se mos ligështoheni në qëndresën tuaj, të tërhequr nga gabimi i të pabesëve.” (2 Pjetrit 3:17) Lutuni që kisha do të mbrohet nga doktrina të rreme dhe nga humbja e besimit në besueshmërinë e Biblës.
E premte 7 Tetor	Falënderoni për numrin e madh të turistëve që vizituan Izraelin këtë verë. Kishte pothuajse numra të njëjtë me ato të vitit 2019, që është viti rekord i numrit të turistëve në Izrael.
E shtunë 8 Tetor Shabat	“Kështu thotë ZOTI i ushtrive: Unë jam shumë xheloz për Sionin, po, unë digjem nga xhelozia për të.” (Zakaria 8:2) Falënderoni që ka qindra vargje biblike që flasin për Jerusalem. Lutuni për sigurinë e Jerusalemit gjatë Festës së ardhme të Kasolleve.
E diel 9 Tetor	Një video e zbuluar nga një shkollë palestineze në Jerusalem tregon studentët duke përformuar një dramë në të cilën ata vrasin hebrenj. Ky është një shembull i mënyrës se si fëmijët po edukohen të urrejnë Izraelin. Lutuni që ky zinxhir urrejtjeje të thyhet te këta fëmijë dhe që ata të edukohen me respekt dhe dashuri për Izraelin.
E hënë 10 Tetor Sukkot	Festa e Kasolleve. Dita e sotme markon fillimin e Festës së Kasolleve (Levitiku 23:33-44). Lutuni që populli hebre të ndihet i strehuar në kasollet e tyre. Lutuni për një festë të sigurt në të cilën terrorizmi nuk do ketë mundësi të shqetësojë gëzimin e festimeve. Lutuni që populli hebre të dijë që Zoti Perëndi është streha e tyre.
E martë 11 Tetor Sukkot	Gjatë festës së Sukkot-it familjarët vizitojnë njëri-tjetrin dhe festojnë së bashku. Lutuni që festa të promovojë unitet dhe dashuri brenda familjeve hebreje.
E mërkurë 12 Tetor Sukkot	Sukkot-i është festë gëzimi. Hebrenjtë janë urdhëruar të jenë të gëzueshëm gjatë saj pavarësisht rrethanave të tyre. Në Dhiatën e Re, te Filipianëve 4:4, të krishterët gjithashtu janë urdhëruar të jenë të gëzueshëm gjatë gjithë kohës. Lutuni që bashkë me popullin hebre, ne do të rritemi në të jetuarit e jetës me gëzim sepse e dimë se Perëndia gjithmonë kujdeset për ne.
E enjte 13 Tetor Sukkot	Zakaria 14:16 premtan se në të ardhmen kombet johebre do të shkojnë në Jerusalem për të festuar Festën e Kasolleve atje. Lutuni që kjo kohë të vijë së shpejti.
E premte 14 Tetor Sukkot	Gjatë Sukkot-it jepet një bekim me anë të disa llojeve të ndryshme të degëve, duke përfshirë degë mirre dhe shelgu. Ato simbolizojnë llojet e ndryshme të njerëzve që kanë nevojë për njëri-tjetrin. Siç ka shumë denominacione brenda mbretërisë së Krishti, ka dhe brenda judaizmit grupe të ndryshme. Lutuni që këto grupe do të jenë të bashkuara në frymë dhe një bekim dhe frymëzim për vëllezërit dhe motrat e tyre jobesimtarë.
E shtunë 15 Tetor Sukkot Shabat	Ka hapje në majë të çadrës ose kasolles (sukkah) për të parë qiellin me yje dhe për të qenë i vetëdijshëm për jetesën në mbrojtjen e Perëndisë. Falënderoni për mbrojtjen e Perëndisë për popullin hebre dhe në jetët tona.
E diel 16 Tetor Sukkot	Sot është dita e fundit e Festës së Tabernakujve. Zoti Jezus foli në ditën e fundit të Sukkot-it fjalë që jehojnë edhe sot. Rojat e tempullit që e dëgjuan thanë: “Kurrë s’ka folur njeri kështu si ky njeri.” (Gjoni 7:37-52). Falënderoni Perëndinë për fjalën e Tij dhe për Birin e Tij.
E hënë 17 Tetor Sukkot	Shemini Atzeret (Dita e fundit e festimit të Sukkot-it). Në këtë ditë të fundit të festimeve, thuhet lutje për shira në tokë që të korrurat e vitit të ardhshëm të jenë të mira. Lutuni për këtë shi bashkë me popullin hebre.
E martë 18 Tetor Simchat Torah	Gëzimi i Ligjit. Sot Festa e Kasolleve përfundon me Simchat Torah (Gëzimi i Ligjit). Falënderoni që ne si të krishterë mund të mësojmë caq shumë (nga hebrenjtë) për këtë gëzim të ligjit, gjithashtu të njohur si urdhërimet ose rregullat e sjelljes. Këto rregulla të sjelljes janë një strehë e sigurt, si një mur mbrojtjes që rrethon jetët tona personale dhe në bashkësi.

E mërkurë 19 Tetor	Ka një mungesë të oficerëve policorë në Izrael. Lutuni që kandidatë të rinj mund të trajnohen shpejt. Gjithashtu lutuni për oficerët policorë aktualë, për forcë që të bëjnë punën e tyre siç duhet.
E enjte 20 Tetor	Ka gjithashtu një mungesë të dukshme të mësuesve. Lutuni që njerëz të rinj të mund të gjenden për të marrë këtë rol. Lutuni për një bekim mbi mësuesit izraelitë dhe që ata të frymëzojnë fëmijët të vendosin besimin e tyre në Perëndinë.
E premte 21 Tetor	“Lutuni për paqen e Jerusalemit, le të begatohen ata që të duan. Pastë paqe brenda mureve të tua dhe begati në pallatet e tua.” (Psalmi 122:6-7) Falënderoni për këtë detyrë të qartë për çdo të krishterë që lexon Psalmet!
E shtunë 22 Tetor Shabat	Gjysma e banorëve të Jerusalemit janë duke jetuar nën nivelin e varfërisë. Një nga arsytet për këtë është se rrogat janë të ulëta por kostoja e jetesës është e lartë. Lutuni për një bekim mbi punën e organizatave që shpërndajnë pako ushqimesh. Gjithashtu lutuni për një zgjidhje përfundimtare të kësaj varfërie.
E diel 23 Tetor	Falënderoni për përmbushjen e profecive bilike dhe lutuni që do vazhdojmë t’i mbajmë sytë tanë hapur ndaj të vërtetave biblike që janë duke u përmbushur në ditët tona. Falënderoni që njësoj si profecitë për Zotin Jezus u përmbushën, profecitë për Izraelin gjithashtu do të përmbushen!
E hënë 24 Tetor	Çdo vit një grup arkeologësh të huaj vijnë në Izrael për të ndihmuar në gërmime. Lutuni që ata do të zbulojnë gjëra që dëshmojnë se populli hebre ka një histori të shumë të gjatë në tokën e Izraelit dhe se Bibla është e besueshme.
E martë 25 Tetor	Lutuni për siguri në rrugët e Izraelit. Kushdo që ka qenë në Izrael e di se trafiku mund të jetë kaotik. Lutuni për mbrojtjen e izraelitëve ndërsa ata udhëtojnë.
E mërkurë 26 Tetor	Shërbimi sekret izraelit përpiket që të parandalojë sa më shumë sulme terrori të mundet duke ndërmarrë misione dhe duke arrestuar terroristë para se sulmet të bëhen. Gjatë muajve të fundit shumë sulme të tjera janë parandaluar dhe disa operacione të trafikimit të armëve janë ndaluar. Falënderoni për këtë.
E enjte 27 Tetor	Falënderoni që misionet e ushtrisë izraelite në Gaza verën e shkuar nuk u përshkallëzuan në një luftë të madhe. Shumë nga raketat dërguar kundër Izraelit u ndaluan nga Kubeja e Hekurt ose ranë në det. Falënderoni për këtë. Gjithashtu në të njëjtën kohë lutuni për mbrojtje ndaj sulmit të raketave nga Gaza. Ai rrezik nuk zhduket asnjëherë plotësisht.
E premte 28 Tetor	Së fundmi është zbuluar se shërbimi islamik i pastrimit ka qenë duke hedhur plehra në pjesën e Malit të Tempullit që është më e shenjta për traditën hebraike. Për shumë hebrenj kjo është tej mase ofenduese. Lutuni që Mali i Tempullit të bëhet një vend ku Perëndia i Izraelit do të adhurohet.
E shtunë 29 Tetor Shabat	“Unë do të bëj që ju të më gjeni”, thotë ZOTI, ‘dhe do t’ju kthej nga robëria juaj; do t’ju mbledh nga të gjitha kombet dhe nga të gjitha vendet ku ju kam shpërndarë’, thotë ZOTI, ‘dhe do t’ju çoj përsëri në vendin prej të cilit ju çova në robëri.’” (Jeremia 29:14) Ky varg thekson “të gjitha kombet” dhe “të gjitha vendet”. Lutuni që ky varg biblik të përmbushet.
E diel 30 Tetor	Këtë verë Izraeli u shokua nga një sulm në një autobus të transportit publik. Një numër njerëzish humbën jetën. Lutuni për ngushëllim për të afërmit e tyre dhe për rikuperim për të lënduarit. Lutuni për izraelitët, mbrojtje nga sulmet terroriste ndërsa vazhdojnë jetët e tyre.
E hënë 31 Tetor	Nesër janë zgjedhjet e Izraelit. Lutuni që në këtë ditë të fundit të fushatave, partitë e ndryshme do të fokusohen në vizionin e tyre për shtetin dhe jo në urrejtjen dhe zilinë midis tyre. Lutuni që njerëzit të jenë në gjendje ta konsiderojnë mirë atë për të cilin votojnë.